



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**

**VENDIM**  
**Nr. 18, Datë 17.12.2024**

**“Për miratimin e strukturës së Dokumentit Analitik, përbërjen e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), Sekretariatit Teknik (ST) dhe Ekspertizës ndërkombëtare, për hartimin e analizës dhe PKV për komponentin III.3 ‘Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë’.”**

Bazuar në nenet 24 dhe 32 - 41 të Rregullores së Kuvendit, në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të datës 27.5.2024 dhe në mbështetje të Vendimit Nr. 50/2024, datë 30.05.2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të Kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

**VENDOSI:**

1. Të miratojë procesverbalin e zbardhur të mbledhjes paraardhëse, të zhvilluar më datë 28.10.2024.
2. Të miratojë në parim strukturën e Dokumentit Analitik/analizës lidhur me Komponentin 3, 'Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë', pjesë përbërëse e Shtyllës III – Sundimi i Ligjit, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi".
3. Të miratojë përbërjen e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Sekretariatit Teknik, si dhe Ekspertizës Ndërkombëtare, të cilët do të angazhohen dhe kontribuojnë në procesin e punës për hartimin e Dokumentit Analitik dhe Planit të Veprimit në kuadër të Shtyllës III “Sundimi i Ligjit” – Komponenti 3 “Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë”, sipas Aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi."
4. Të miratojë në parim dokumentet bazë orientuese, mbi të cilat do të mbështetet procesi i punës për analizën e Komponentit III.3 “Konsolidimi i Reformës në Drejtësi”, sipas Aneksit 3 bashkëlidhur këtij vendimi."
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**FATMIR XHAFAJ**